








revista REFLEKTIME

Nr. 1, qershor 2022



ÇDO FËMIJË MERITON NJE MUNDËSI TË RE



Nëse ndihesh i lodhur gjatë ditës,
së dëshirës mos nguro të dypresësh,
të kërkesë pushim plotësimin e nevojave
të tua si dhe të kaltesh kohën kur
ndihesh i gatshëm për të dëshmuar.

Policia, punonjësi për mbrojtjen e familjes,
prokurori ose gjyqtari do të ndihyjnë
mejetëri dhe në çdo kohë për të:
- të mbrojtur nëse ndihesh i rrezikuar;
- shpërngur çdo kontakt me të detyruar;
- mes qyqur identifikim të fundit.

QUNUAN:
NXËNËSIT E SHKOLLËS
"TIRANA JONË"

MODELET PËR RIINTEGRIMIN

PROF. DR. VASILIKA HYSI

Të dashur fëmijë,
Të dashur prindër,
Të dashur profesionistë, që një pjesë të jetës suaj ua dedikoni fëmijëve,
Interesi më i lartë i fëmijës është qëllimi që duhet të përmbushet në të gjitha vendimet dhe veprimet që merren në lidhje me fëmijën. Çdo fëmijë duhet të gëzojë të drejtën për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e shoqëror; të gëzojë një jetë familjare e shoqërore të përshtatshme për të, pavarësisht moshës, gjinisë, etnisë, gjuhës, ngjyrës, shtetësisë, besimit, orientimit seksual, identitetit gjinor, pozitës shoqërore, gjendjen familjare, vendbanimit, gjendjen shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, pamjes së jashtme, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë etj.
Çdo prind, ose kujdestar i fëmijës, ka përgjegjësi parësore t'i krijojë fëmijës kushtet e jetesës, t'i garantojë mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin. Institucionet dhe shoqëria kanë përgjegjësi për të mundësuar që çdo fëmijë të jetojë dhe të rritet në një mjedis



të përshtatshëm familjar.
Por ndodh që jeta të vendosë një fëmijë në kushte që ai të jetë viktimë, dëshmitar, të bëjë një gabim të dënueshëm nga ligji, me dashje ose nga pakujdesia. Momente të tilla nuk janë të lehta për fëmijën. Sistemi i drejtësisë që kemi krijuar me ligj dhe synojnë të zbatojmë, duhet të jetë miqësor për fëmijët. Ndarja e fëmijës nga familja duhet të jetë zgjidhja e fundit.
Mund të ndodhë që rrugëtimi të mos jetë i lehtë, por kujdesi për rritjen, edukimin dhe rehabilitimin e fëmijës është detyrë e secilit prej nesh. Unë besoj se nuk ka fëmijë që nuk mund të korrigjohet dhe të riintegrohet në shoqëri, por ka modele të suksesshme ose jo miqësore për fëmijën. Ndaj, çdo profesionist i angazhuar në shërbimet për fëmijët, duhet të mbajnë parasysh nevojat për zhvillim fizik, psikologjik, edukim e shëndet, siguri dhe qëndrueshmëri në rritjen e fëmijës në familje dhe jo i veçuar prej saj, si dhe të bëjë çdo përpjekje që t'i kthejë buzëqeshjen atij.
Ky proces do të jetë më i mbarë dhe i lehtë, nëse fëmija merr pjesë aktivisht dhe profesionistët

krijojnë një mjedis miqësor për të, duke respektuar jetën private dhe familjare të tij. Bashkërisht me fëmijët mund t'ia dalim, duke kontribuar për një sistem institucionesh miqësore për fëmijët.

Të dashur lexues/e,
Ky është botimi i parë, ku të gjithë anëtarët e një skuadre kanë shprehur mendimet nga këndvështrimi i tyre. Edhe unë si një pedagoge, që i jam kushtuar për shumë vite drejtësisë për të mitur dhe ligjbërjes, kam bindjen se një botim i tillë do të vijojë dhe do të nxisë ide, mendime dhe sugjerime se çfarë familja, institucionet, shoqëria, fëmija, cilindo prej nesh duhet të bëjmë më mirë. Modelet e mira të fëmijëve të riintegruar do të frymëzojnë fëmijë të tjerë, që në një moment në jetën e tyre mund të gabojnë, por besimi se mund dhe do t'i rikthehen jetës si gjithë moshatarët e tyre nuk do të mungojë.



Le të jetë ky botim, një platformë e ndarjes së përvojave e mendimeve dhe një pikënisje për të vlerësuar se çfarë do të duhet të bëhet me mirë për fëmijët dhe me fëmijët!

*Miqësisht,
Prof. dr. Vasilika Hysi*



Drejësia do të jetë
mësoke me ty!

Procesi do të jetë i shkurorë!
Policia, prokuroria apo gjykata,
do të marrin maso në mënyrë që ti të
qetesh:
-sa më pak herë që të jete e mundur
-në orare dhe mjedise të
përshtatshme për ty
-për një kohë jo të gjatë.




Në çdo kohë ti mund:

- ✓ të lërkosh të dëgjosh;
- ✓ të shprehësh dikshëm mendimin tënd.

Puruar:
Nënësit e Shkollës
"Tirana Jonë".

Policia, prokuroria, gjykatari, qunonësi
për mungjen e familjes, avokatit dhe psikologu
do të kujdesen për ty. Atë do të të mbledhin,
keshillojnë dhe do të të mbajnë.
Ti do të trajtoresh me
respekt dhe me dinqitet!



NJË REVISTË PËR TË REFLEKTUAR

KLAUDIA HASANLLARI

Sa herë që një i/e mitur apo i/e re, qoftë ai/ajo një viktimë, dëshmitar apo autor i veprës penale përballet me sistemin e drejtësisë, është shumë e rëndësishme që i gjithë zinxhiri institucional të zbatojë procedurat e përshkruara mirë, jo vetëm për gjykimin e tyre, por mbi të gjitha për rehabilitimin dhe riintegrimin e këtyre të miturve apo të rinjve në shoqëri. Të gjithë profesionistët e këtij zinxhiri angazhohen dhe punojnë së bashku për t'i ndihmuar këta të mitur dhe të rinj, duke u krijuar mundësi më të mira dhe duke i orientuar ata drejt shkollimit, edukimit, përfitimit të aftësive profesionale, kulturës, artit, sporteve dhe zhvillimit të talenteve individuale, që deri më tani rezultojnë të jenë “kundërhelmi” më i mirë ndaj recidivizmit (rikthimit në krim). Por këto arritje pozitive realizohen vetëm kur një i/e mitur apo i/e ri/e në kontakt apo konflikt me ligjin vë re që profesionistët e përfshirë në sistemin e drejtësisë e trajtojnë atë me respekt, i njohin dëmin që i është shkaktuar dhe kërkojnë zgjidhjen më të mirë të mundshme për ta kthyer këtë individ në rrugën e një zhvillimi të harmonishëm. Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe

të Rinjve, si një institucion që zbaton politikat e ministrit të Drejtësisë në fushën e drejtësisë penale për të mitur, koordinon në mënyrë të vazhdueshme me të gjithë forumin ndërsektorial dhe ndërinstitutional në ndihmë të të miturve dhe të rinjve në konflikt me ligjin, si dhe me vetë të miturit e të rinjtë që janë pjesë e procesit penal. Gjatë kësaj pune, është e lehtë të kuptosh vështirësitë që hasin këta profesionistë, sfidat, por mbi të gjitha edhe kënaqësinë që marrin kur një i mitur rehabilitohet dhe riintegrohet në shoqëri. E, megjithatë, përballë historive të ndryshme, është e pashmangshme të mos ngrihen pyetje, të cilat kanë nevojë për një reflektim jo vetëm profesional, por edhe njerëzor për të marrë përgjigjet e duhura. Ndëshkim për fëmijën, apo rehabilitim në gjirin e komunitetit të tij? E fitojmë apo e humbasim një të ri, i cili për një arsye apo një tjetër ka rënë në kontakt me ligjin, nëse e trajtojmë atë si një kriminel? A duhet të vazhdojmë të luftojmë pasojën apo duhet të përqendrohemi te shkaku? A mos duhet që shoqëria të marrë një rol tjetër veç atij të spektatorit në këto raste? Këto janë pak nga pyetjet, me të cilat ne si punonjës të drejtësisë penale për të mitur ndeshemi çdo ditë dhe përpiqemi t'u japim një përgjigje. Shpeshherë

është e pamundur që historitë dhe arsyet që fshihen pas këtyre rasteve të mos mbeten në mendje dhe të mos shërbejnë si një kampanë reflektimi për rolin tonë si profesionistë, por mbi të gjitha për rolin e secilit prej nesh si qytetarë të kësaj shoqërie. Ndaj botimi i kësaj reviste, me disa nga historitë apo qëndrimet e punonjësve të institucioneve të ndryshme përgjegjëse për të miturit në konflikt me ligjin, por edhe histori të vetë të miturve, që po vuajnë dënimin dhe prindërve të tyre, synon të nxisë procesin e reflektimit të lexuesi jo vetëm për arsyet që e çojnë një të mitur drejt krimit, por edhe për atë që secili prej nesh, profesionist i drejtësisë ose jo, mund të bëjë për të ndihmuar parandalimin e këtyre rasteve. Duke falënderuar Qendrën Kombëtare të Librit dhe Leximit për mbështetjen e kësaj iniciative dhe secilin prej bashkëpunëtorëve që shkëmbyen eksperiencat dhe mendimet e tyre në këto intervista, shpresojmë që ky botim i parë, të shërbejë sadopak në njohjen e sistemit dhe përmirësimin e qasjes drejt të miturve në konflikt me ligjin, mirëpresim reflektimet e secilit prej lexuesve për t'i paraqitur ato në një botim të dytë.

*Qendra e Parandalimit
të Krimeve të të Miturve
dhe të Rinjve*

1. Prezantimi juaj hyrës

Unë jam Anisa Subashi dhe që prej vitit 2019 drejtoj Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve Sociale në Bashkinë Tiranë.

Studimet dhe eksperiencia në fushën sociale e kanë ndihmuar rrugëtimin në ndërtimin e një vizioni mbi shërbimet, por duhet të theksoj se, menaxhimi i gjithë detyrave dhe funksioneve kërkon kohë, përkushtim dhe mbi të gjitha energji dhe forcë. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Tiranë përbëhet nga gjashtë drejtori, përkatësisht: Drejtoria e Politikave Lokale Arsimore, Drejtoria e Mbrojtjes dhe e Përfshirjes Sociale, Drejtoria e Strehimit Social, Drejtoria e Nxitjes së Punësimit, Drejtoria e Rindërtimit të Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Kujdesit Social dhe Shërbimet e Integruara. Secila prej këtyre drejtorive në varësi ka tipologjitë e shërbimeve, politikave dhe kategoritë, të cilat afektojnë në punën e përditshme.

Për ofrimin e shërbimeve për grupet e ndryshme në nevojë, bashkia ka ngritur gjashtë qendra komunitare në zona të ndryshme, përkatësisht: Qendra Sociale Multidisiplinare, Qendra “Të qëndrojmë së bashku”, Qendra Komunitare “Gonxhe Bojaxhi”, Qendra Komunitare Shkozë, Qendra Sociale “Strehëza”, Qendra Komunitare e Terrenit.

2. Nga eksperiencia juaj si drejtuese e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Tiranë, sa e vështirë është për ju të ofroni shërbime për të miturit në konflikt, apo kontakt me ligjin?

Drejtësia penale për të miturit është përmirësuar vitet e fundit, i mbron ata nga dënimi me heqje lirie, duke ofruar alternativa të tjera, më së shumti edukative, ndërsa ekspertët vërejnë se disa

ANISA SUBASHI: VËMENDJA JONË DUHET TË JETË FAMILJA


INTERVISTË ME DREJTORESHËN E SHËRBIMEVE SOCIALE, BASHKIA TIRANË, ANISA SUBASHI

institucione nuk i respektojnë këto masa lehtësuese. Në Shqipëri, gjithnjë e më shumë po rritet shqetësimi mbi përfshirjen e të miturve në vepra të ndryshme penale, apo përdorimin e tyre nga grupe kriminale. Autoritetet policore raportojnë se numri më i lartë i të miturve të dyshuar si autorë, paraqitet për “Vjedhje”, dhe “Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor” dhe prodhim e shitje të lëndëve narkotike. Duke iu referuar shifrave dhe asistimit në komisariate përgjatë viteve 2021-2022, mund të themi se janë asistuar dhe trajtuar 151 raste të fëmijëve në konflikt me ligjin.

Rastet në konflikt me ligjin kanë qenë të problematikave të ndryshme, duke përfshirë: dhunë me bashkëmoshatarët, konflikt me armë të ftohta, vjedhje/dëmtim, dhunë fizike dhe psikologjike, seksuale, shfrytëzim ekonomik, vjedhje, çrregullime të sjelljes, konflikt, lëndë narkotike dhe trafikim. Të gjitha këto raste janë menaxhuar dhe janë ofruar shërbime sipas specifikave nga PMF (Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijëve), të cilët kanë ofruar shërbime në bazë të problematikave që ata kanë pasur. Hallkat e sistemit lidhen nga Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës, i cili për këto raste në veçanti punon në rikthimin në shkollë, marrjen e shërbimeve komunitare, trajtimin e varësisë nga lëndët narkotike dhe mbi të gjitha fuqizimin ekonomik të familjes dhe forcimin e marrëdhënies prind-fëmijë. Miratimi i Kodit të

Drejtësisë Penale për të Mitur dhe protokollet përkatëse për menaxhimin e fëmijëve në konflikt me ligjin, kanë lehtësuar punën tonë, por sfida jonë e përditshme është krijimi i besimit mes strukturës shtetërore dhe fëmijës në nevojë për mbrojtje. Çdo rast mbart problematika, të cilat kërkojnë të identifikohen për t’u bërë ndërhyrjet e nevojshme dhe më pas të trajtohen në vazhdimësi. Përdorimi i dhomave miqësore për të mitur është një hap para në trajtimin e tyre.

Strukturat e mbrojtjes së fëmijëve, në momentin e parë që përballen me një rast në komisariat, prirën të mbulojnë nevojat emergjente të rastit, me qëllim zbutjen e traumës nga e cila ata vijnë dhe më e rëndësishmja shmangia e riviktimizimit, apo përsëritja e traumave, të cilat mund të shkaktohen nga pyetja disa herë e fëmijëve. Përveç përdorimit të dhomave miqësore, risi janë: Përcaktimi i përfaqësuesve proceduralë, bashkëpunimi me disa komisariate, ku në fokus të takimeve kanë qenë identifikimi dhe parandalimi i rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin. Bashkëpunimi me IEVP Kavajë: Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës në bashkëpunim me IEVP Kavajë, ka hartuar në mënyrë periodike Planet Individuale të Mbrojtjes (PIM) për rastet që janë liruar nga dënimi. PIM janë hartuar nga Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës, në bashkëpunim me Grupin Teknik Ndërsektorial, ku në fokus është riintegrimi i të miturve.



Bashkëpunimi me institucione të tjera: Në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin, NJMF dhe PMF në Njësitë Administrative kanë forcuar bashkëpunimin me Shërbimin e Provës, Qendrën e Parandalimit të Dhunës, Zyrën e Koordinatorit të Viktimave dhe Qendrat Komunitare të Bashkisë Tiranë.

Fuqizimi i kapaciteteve të profesionistëve: janë trajnuar punonjësit për mbrojtjen e fëmijës për procedurat e menaxhimit të rasteve të fëmijëve në konflikt me ligjin. Fëmijët në konflikt, apo kontakt me ligjin, kanë një historik, i cili shpesh buron nga probleme në familje apo komunitet, ndaj dhe qasja jonë është drejt identifikimit të hershëm dhe parandalimit.

Ajo çfarë Bashkia Tiranë synon, është të krijojë besimin mes institucioneve dhe shërbimeve që ne ofrojmë dhe fëmijës/familjes së tij.



3. A mund të ndani me ne një rast sukseesi të një të mituri, i cili ka qenë në konflikt me ligjin dhe që Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale në Bashkinë Tiranë ka trajtuar?

Nëse do të flasim për një rast sukseesi, duke lënë mënjanë edhe modestinë, do të thosha që kemi disa, sepse rast sukseesi për ne është kur fëmija merr shërbimet e nevojshme, si paketa, pagesë qiraje, shpërngulje nga shkolla, regjistrime në kurse etj. Rast pas rasti, në bazë të problematikave që hasen, Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës është aty, për t'i menaxhuar dhe ofruar shërbimet. Të gjithë fëmijët janë të barabartë dhe gëzojnë të drejta të barabarta, në këtë mënyrë plani i mbrojtjes së fëmijëve nuk përfshin vetëm fëmijën. Ne e dimë që janë një sërë aktorësh që kontribuojnë në riintegrimin e tyre në shoqëri, ndaj vëmendja duhet të fokusohet te familja, ku secili prej nesh, të bëjë të mundur fuqizimin e saj. Të miturit, në konflikt me ligjin, janë produkt i shoqërisë, andaj shoqëria ka detyrimin ligjor e moral të kujdeset për ta. Ata kanë nevojë për vëmendje, kujdes e mbrojtje, nga të gjithë këta aktorë që janë pjesë e sistemit për t'i trajtuar këta fëmijë me drejtësi dhe barazi, ashtu si çdo i ri i moshës së tyre, sepse kanë të drejtën e garantimit të një të ardhmeje si të çdo qytetari të lirë.

4. Cili është mesazhi që do të donit të jepnit për të gjithë profesionistët që punojnë me të miturit dhe për vetë të miturit?

Në rolin e drejtueses së shërbimeve sociale, por edhe si pedagoge, kolege e shumë profesionistëve të rinj, apo atyre me eksperiencë, të cilët punojnë me fëmijët në konflikt me ligjin, do të doja së pari të falënderoja dhe vlerësoja punën e palodhur të secilit prej tyre, duke filluar nga punonjësit socialë në komunitet, të cilët bëjnë identifikimin e këtyre rasteve, e duke vijuar me punonjësit socialë në shkolla, që shpesh ndeshen me problematika të dhunës në shkolla, punonjësit socialë, që bëjnë asistimin në komisarate, punonjësit e qendrave komunitare, të cilët kryejnë monitorimin dhe ofrojnë mbështetje për të miturit në konflikt me ligjin, si dhe 27 punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve në çdo njësi administrative të Bashkisë Tiranë. Çdo profesionist, i cili punon me fëmijët, apo për fëmijët, jep një kontribut të madh në ndërtimin e një shoqërie, e cila mbron interesin më të lartë të tyre.

Drejtëria do
me tregojë
il TPI!



Unicef!

Te drejtat e
fëmijëve!

Në sdo kohë

TI:

- kërko të dëgjohesh!
- shpreh lirshëm mendimin tënd!
- të kesh psikolog falas!



ANISA ZAÇE: ROLI I INSTITUCIONEVE

INTERVISTË ME PSIKOLOGEN ANISA ZAÇE

1. Prezantimi juaj hyrës

Unë jam Anisa Zaçe, psikologe klinike dhe këshillimi. Kam përfunduar studimet Master në Francë dhe në Shqipëri. Aktualisht punoj me grupmosha të ndryshme të rriturish, me problematika të ndryshme, si probleme të ankthit, probleme emocionale etj.

2. A keni trajtuar raste të të miturve në konflikt me ligjin?

Kam pasur raste të të miturve me sjellje deviate, që në të ardhmen do të mund të ktheheshin lehtësisht në veprime në konflikt me ligjin.

3. Sipas mendimit tuaj, cilat janë shkaqet që e çojnë një të mitur, apo të ri të kryejë një vepër penale?

Shkaqet mund të jenë nga më të ndryshmet, duke filluar që nga kushtet familjare, në të cilat janë rritur, e deri te rrethanat sociale. Pra, me kë shoqërohet, si e kalon kohën e lirë, mbarëvajtja në shkollë, si edhe jeta sociale. Patjetër që mungesa e mirëqenies emocionale mbetet

një faktor i rëndësishëm për sjellje të papërshtatshme të të miturve dhe jo vetëm.

4. Cili duhet të jetë roli i institucioneve shtetërore në trajtimin e këtyre rasteve?

Mendoj se roli i institucioneve duhet të jetë një rol larg kulturës së ndëshkimit. Institucionet duhet të jenë sa më shumë eksploruese mbi arsyet që çojnë deri në ndëshkim dhe ndihmuese për të kapërcyer problematika të ndryshme.

Gjithashtu, institucionet shtetërore duhet të jenë mbështetëse dhe të hapura, në mënyrë që të rinjtë të kenë besim për të kërkuar ndihmë.

5. Sipas mendimit tuaj, sa i rëndësishëm është roli i psikologut në punën me të miturit që janë në konflikt me ligjin?

Roli i psikologut është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Të miturit, në konflikt me ligjin, problematikat kryesore i kanë të fshehura në mungesa emocionale. Ndihma psikologjike, në të tilla momente, është vendimtare.

6. A janë të gatshëm fëmijët të hapen dhe të bisedojnë

me një profesionist apo psikolog për problemet e tyre? Cila është qasja që një psikolog duhet të ketë gjatë intervistës me të miturit?

Biseda me një të mitur zhvillohet krejt ndryshe nga ajo me një të rritur. Si në çdo marrëdhënie tjetër, besimi fitohet. Profesionisti duhet ta ndërtojë marrëdhënien në formë të tillë që të krijojë hapësira për të fituar besimin. Qasjet janë të ndryshme, e rëndësishme është që në të tillë rast rregulli më i rëndësishëm është ruajtja e interesit më të lartë të të miturit.

7. Çfarë mund të bëjë më mirë shoqëria shqiptare për të trajtuar rastet e të miturve në konflikt me ligjin?

Shoqëria shqiptare duhet të jetë më e ndjeshme ndaj problematikave, të kuptojë që asgjë nuk ndodh rastësisht, të jetë e hapur ndaj ndihmës për më të tërhequrit, të edukojë fëmijë të ndjeshëm e jo bullizues. Kjo arrihet, si çdo gjë e bukur në këtë jetë, duke dhënë shumë dashuri te fëmijët, e ata do e japin mes njëri-tjetrit. Bota ndryshon me një përqafim!

Eliana Meda

[Signature]

Indrit Koka
[Signature]

Keisi Kadriaj
[Signature]


Indrit Kuka

[Signature]

"Sami Frashëri"

KALTRI Tola "Sami Frashëri"

[Signature]



INTERVISTË ME EDUKATORIN E IM KAVAJË

1. Sa sfiduese është të punoni me të miturit?

Puna me të miturit është tepër sfiduese, sepse, ndryshe nga të rriturit, të miturit nuk kuptojnë, por dhe kuptojnë në të njëjtën kohë. Nëse të rriturit thonë një fjalë dhe e mbajnë, të miturit nuk ta kthejnë përgjegjësinë.

2. Sa vite keni që punoni me të miturit, a janë bashkëpunues?

Kam mbi 11 vite, kohë shumë e gjatë! Personalisht me mua janë bashkëpunues, duke qenë se kam eksperiencë të gjatë dhe më pyesin vazhdimisht.

3. Si ka ndryshuar qasja juaj në këto 11 vite? Më sfiduese ka qenë atëherë apo tani?

Në fillimet e veta, ku institucioni ishte i sapohapur, stafi ishte i gjithi i ri dhe nuk kishte eksperiencë me të mitur, vetëm

punonjësit me uniformë kishin eksperiencë me të rriturit. Duke qenë në këtë situatë, puna kishte më shumë stres, më shumë trysni, por sot janë bërë ligjet më të favorshme dhe tashmë pjesa më e madhe e stafit ka eksperiencë dhe japin variantin e tyre më të mirë, kuptohet brenda kornizave të ligjit.

4. Çfarë do të donit të ndryshonit në punën tuaj, që ta përmirësonit në procesin e rehabilitimit të të miturve?

Procesi i rehabilitimit të të miturve te ne është hallka e dytë dhe ka shumë gjëra që duhen ndryshuar, ka shumë hallka që duhet të ndryshohen dhe të implementohen. Ndërsa për sa i përket ligjit, në tërësi është një ligj i mirë dhe mjaft i favorshëm. I mituri trajtohet te ne, por problemi fillon pasi del nga

institucioni. Ne kemi pasur raste ku i mituri, pasi del nga ky institucion, sapo shkon në lagje pasdite shoqëria e pret me hashash dhe nisin vjedhjet. Kjo gjë ndodh në shumicën e rasteve.

5. Cili është mesazhi juaj për të miturit dhe për të gjithë lexuesit e revistës?

Të miturit duhet të reflektojnë përpara se të bëjnë veprime që i çojnë në konflikt me ligjin. Mos ta dëgjojnë shoqërinë, por të impenjohen te familja dhe të shohin çfarë është më e mira për ta.

6. Në këto 11 vite eksperiencë, a keni pasur ndonjë rast që ju ka lënë përshtypje dhe ju ka ngelur gjatë në memorie?

Ka raste të shumta, por zakonisht më të fiksuarat janë ato të fillimit.

INTERVISTË ME TË MITURIN NË IM KAVAJË

Sa vjeç jeni dhe pse jeni dënuar?

Jam 17 vjeç dhe jam dënuar për veprën penale “vrasje”.

Si ishte dita juaj para se të hynit në IM Kavajë?

Para se të hyja në IM Kavajë ndiqja shkollën, isha nxënës në vitin e dytë gjimnaz. Frekuentoja lojërat sportive së bashku me shokët dhe kaloja shumë mirë me të gjithë. Gjatë gjithë ditës pikturoja nga mëngjesi deri në darkë, por kishte raste që dilja vetëm për pak, në mënyrë që të qetësohesha dhe më pas kthehesha dhe vijoja të pikturoja.

Kishit një rreth të gjerë shoqëror?

Jo, nuk kam pasur shumë shokë.

Çfarë menduat ditën e parë që erdhët në Institutin e të Miturve? Ishte e lehtë përshtatja?

Nuk ishte aspak e lehtë të përshtatesha. Mendimi se do të izolohehesha, se do të rrija brenda në një dhomë të vogël burgu dhe krejtësisht vetëm, nuk ishte aspak i lehtë.

Po marrëdhënia me bashkëmoshatarët e tu dhe stafin është e lehtë?

Po, po është e lehtë. Kam zënë shokë të rinj dhe rrimë të gjithë së bashku. Ia kalojmë bukur!

Si e kaloni ditën tuaj këtu?

Çfarë ju pëlqen të bëni? Ku aktivizoheni më shumë?

Këtu angazhohem më shumë me pikturën, si edhe rregulloj korniza me kunja. Gjithashtu bëjmë dhe aktivitete të tjera, luajmë futboll dhe shkojmë në palestër.

Si është marrëdhënia juaj me institucionet e drejtësisë? Ju kanë mbështetur dhe ofruar ndihmë, avokat, psikolog, punonjës social?

Po, unë tani e kam marrë

mbështetjen, tani që nuk më duhet! Para disa viteve, kohë në të cilën kisha nevojë, nuk e kisha mbështetjen.

Çfarë kuptoni me para disa vitesh?

Dua të them që mbështetje psikologjike nuk kam pasur.

A keni kërkuar ju mbështetje psikologjike?

Jo, nuk kam kërkuar, sepse nuk i dija rrethanat; në atë kohë jeta ka qenë shumë e zhurmshme.

Po tani keni kontakte ose takime me psikolog?

Psikologun duhet ta takoj një herë në muaj, për një vit radhazi, por ende nuk e kam takuar dhe arsye akoma nuk e di!

Nëse psikologu ju vjen, a jeni i gatshëm të flisni me të?

Po, jam shumë i gatshëm.

A ju kanë folur për mundësi punësimi pasi të dilni nga institucioni? A keni ndonjë dëshirë që mund t'ju ndihmojmë ta realizoni?

Nuk kam asnjë dëshirë tjetër, përveçse të mbaroj shkollën.

A po e ndiqni shkollën këtu?

Në çfarë viti jeni?

Akoma nuk e kam nisur, vitin tjetër regjistrohem, por klasat jam duke i ndjekur çdo ditë.

Keni ndonjë lëndë të preferuar?

Përveç artit më pëlqen edhe historia dhe gjeografia.

Çfarë do të donit të bëheshit në të ardhmen, cili do të ishte profilizimi juaj?

Synimi im ishte të mbaroja Akademinë e Arteve, por me futjen time këtu brenda, kjo ëndërr mbeti në mes.

Nëse ne të tre jemi duke ecur së bashku në rrugë dhe ju do të shikonit një person tjetër që është duke bërë të njëjtën vepër që ju keni bërë, çfarë do të bënit?

Do të përpiqesha që të

kuptoja se çfarë mendimesh ka dhe t'i mundësoja atij një takim me psikologun. Do të mundohesha të kuptoja nëse është i rrezikshëm në jetën e përditshme, dhe nëse nuk është i rrezikshëm do ta liroja, ose do ta lija në arrest shtëpie. Burgu të vret më shumë, duke qenë se do të jetë një kohë e gjatë që do të kalosh i izoluar. Zgjidhja më e mirë do të ishte arresti i shtëpisë, duke e lënë me të afërmit, por, sigurisht, duhet parë nëse është ai i aftë të rrijë në jetën e përditshme.

Cili është mesazhi që

do u jepje të gjithë

bashkëmoshatarëve të tu?

Unë kam bërë gabime, të gjithë bëjnë gabime, por ato duhet të pranohen dhe t'i vuash që t'i kuptosh.

Nëse do të kthejmë kohën pas, çfarë do të bënit ndryshe?

Nuk do të isha më gjaknxehtë, pasi në situata të ndryshme reagoj shpejt, pa u menduar mirë.

A ka ndikuar situata në qytetin ku jetonit, fjalët e njerëzve?

Po, edhe ka ndikuar.

Sa ju ka ndryshuar eksperiencia në IM Kavajë?

Më ka ndryshuar 100%, nuk jam më ai që kam qenë. Gjatë kësaj kohe këtu, kam kuptuar se nuk duhet të shoqërohesha me persona më të rritur se vetja dhe se duhej t'i përkushtohesha vetëm shkollës.

Si e mendoni veten në të ardhmen? Çfarë do të donit të bënit me jetën tuaj?

Dëshira ime është që të nis një jetë të re, një jetë normale dhe të hapja një studio pikturë.

Imagjinoni sikur unë jam psikologu juaj, çfarë do të donit që të dëgjoja?



Dua të jetë një psikolog që merret me të miturit, i cili arrin t'i kuptojë sjelljet dhe mendimet e tyre. Kur mua më duhej psikologu, nuk e kisha, tani nuk kam më nevojë.

Pse mendoni se tani nuk keni nevojë për psikolog?

Tani jam brenda mureve, i mbyllur, dhe asgjë nuk ndryshon më; këtu i kupton gabimet dhe mërzitësh e stresohesh.

Psikologu nuk ju tregon ju gabimet që keni bërë dhe t'ju mësojë se çfarë duhet të bëni. Psikologu është një person që ju dëgjon, të gjithë kemi nevojë për një njeri që të na dëgjojë.

Çfarë do të dëgjojë psikologu nga unë, gabimet e mia?! Ashtu do të mërzitem më shumë! Unë i pranoj dhe i di shumë mirë gabimet e mia, kam bërë një gabim që nuk më falet. E kam kuptuar vonë se çfarë gabimi kam bërë dhe ky veprim ka pasoja.

Po, duke i thënë gabimet, ju do i mendoni dhe do i reflektoni.

Tashmë kemi reflektuar. Vetë mjedisi këtu të bën të mendosh.

Ju mendoni se jeni i keq?

Jo, unë nuk e mendoj ashtu, por askush nuk të beson nëse nuk ke një njeri që të njeh.

Unë të besoj, me kaq herë sa të kam takuar unë të besoj, pasi dikush duket nga sytë dhe

shenja e pendesës.

Çfarë mesazhi do t'u jepje bashkëmoshatarëve të tu, të cilët kur ta lexojnë këtë revistë të lexojnë edhe mendimet e tua?

Bashkëmoshatarëve dua t'u them që të jenë më të zgjuar, të ndjekin shkollën, sepse po nuk e ndoqën shkollën do të përfundojnë në Institutin e të Miturve në Kavajë.

Njerëzit mund të bëhen më të zgjuar duke lexuar, duke studiuar...

I zgjuar mund të bëhesh pasi të vuash, ose pasi të ketë ndodhë diçka, ndryshe nuk mund të bëhesh. Tani unë e kam kuptuar dhe kjo mund të më vlejë kur të dal jashtë, por për një kohë të gjatë do të rri këtu dhe nuk do të më vlejë shumë.

Ju jeni Qendra e Parandalimit të Krimeve të të Miturve dhe të Rinjve dhe në qytetin tim mund të ketë raste si ky imi. Ju mund të shkoni, të verifikoni, të takoni të miturin, t'i shikoni listën e notave, të flisni edhe me mësuesit sesi sillet ky i mitur dhe mund ta parandaloni. Të kuptoni sesi i ka mendimet, pasi një fëmijë të vogël arrin t'ia kuptosh mendimet dhe sjelljet se çfarë do të bëjë. Pjesa më e madhe e tyre do ta kuptojnë pasi të vuajnë këtu brenda. Sikur qoftë

edhe dy ditë të rrish këtu brenda e kupton, sepse për një të mitur qëndrimi në institucionin e ekzekutimit të vendimeve penale është hallka e fundit.

Por qëndrimi këtu të maturon...

Qëndrimi këtu do të ngelet për një kohë të gjatë dhe je i lodhur derisa të dalësh. Mua më presin të gjithë kur të dal jashtë, më presin shokët.

Ka njerëz që duan t'ju ndihmojnë të dëgjojnë.

I vetmi njeri që nuk të ndihmon është gjykatësi, ai duhet të shohë nenin, jo njeriun. Pse të miturit vijnë në IM Kavajë direkt për një vjedhje, pse nuk i shohin hallkat e tjera, si arsyeja ekonomike, shkolla etj., por Komisariati i sjell direkt në IM Kavajë? Dhe derisa të zhvillohen seancat gjyqësore, të miturit i ka mbaruar dënimi. Këtu vijnë shumë persona. Një individ që është i dëmshëm për jetën jashtë normal që do të vijë. Edhe unë dikur isha i dëmshëm, sepse një fëmijë nuk duhet të mbajë armë me vete.

Do të na jepni një mesazh të fundit për njerëzit që do ta lexojnë këtë revistë?

Po nuk gabuan, nuk do të mësojnë, dhe nëse nuk gabojnë vetë, të mësojnë nga gabimet e të tjerëve.

INTERVISTA ME DREJTORESHËN E INSTITUTIT TË TË MITURVE, KAVAJË, ZNJ. MARINELA ALIA

1. Sa kohë keni në këtë detyrë dhe a keni punuar më parë në karrierën tuaj me të mitur ose të rinj? Nga ndryshon kjo eksperiencë e re?

Periudha ime si titullare e Institutit të të Miturve Kavajë është relativisht e shkurtër, unë kam 4 muaj që jam emëruar në krye të këtij institucioni, por e gjithë karriera ime prej 16 vitesh ka qenë me në fokus fëmijët, të rinjtë, pra gjithçka që lidhet me mirë me sjelljen, ndërveprimet, përshtatjen, aftësimin e fëmijëve në shkollë.

Karriera ime ka qenë e shtrirë si punonjëse e shërbimit psikosocial në ZVAP Kavajë dhe kam punuar me grupmosha të ndryshme nga 6-15 vjeç në shkollat 9-vjeçare dhe prej 5 vitesh me grupmoshat 15-18 vjeç në arsimin e mesëm të përgjithshëm.

Gjithashtu, gjatë një periudhe 16-vjeçare kam mbuluar koordinimin e shërbimit psikosocial për qytetin e Kavajës dhe të Rrogoshtinës, si dhe kam qenë kryetare e komisionit multidisiplinar për vlerësimin e nevojave të fëmijëve me aftësi ndryshe, duke mundur bashkë me kolegë të tjerë mbulimin me mësues ndihmës, referuar nevojave specifike pranë Zyrës Vendore Arsimore Kavajë. Të gjitha këto i specifikova, për të theksuar se puna ime është e lidhur ngushtë me ndërveprimet e sjelljes, mënyrat e komunikimit, partneritetin shkollë-komunitet-familje, me në qendër nxënësin, pra fëmijët apo të rinjtë.

Pa dyshim që kjo është një eksperiencë krejt ndryshe,

shumë herë më sensitive, pasi drejtimi i një institucioni të të miturve/të rinjve në konflikt me ligjin, pikërisht për këtë fakt është shumë herë më i ndjeshëm, parë kjo nga shumë dinamika.

Ti gjendesh përballë një të mituri, i cili përjeton një mori emocione në përballjen e parë me institucionin, uniformën e policisë, me të panjohurën dhe mbi të gjitha larg familjes. Në këto kushte, patjetër që unë si titullare institucioni mundohem t'i splotohem sadopak petkut institucional, duke i qasur vetes shumë herë më tepër përkujdesjen njerëzore, krijimin e një ure të parë komunikimi e ndërveprimi, duke treguar sa etikë profesionale po aq dhe përkujdesje prindërore.

2. Cili është misioni juaj në këtë detyrë dhe si mendoni ta realizoni?

Fjala mision, në drejtimin e një institucioni të tillë, për mua, nënkupton ndërthurjen ndërmjet qasjes pozitive ndaj ligjit dhe ndërgjegjësimit, reflektimit, integritit, besueshmërisë, shpresës, si dhe çdo detaji dhe elementi tjetër, i cili sado i vogël mund të bëjë diferencën, qoftë edhe te një individ i vetëm. “Dielli ndriçon çdo ditë për secilin prej nesh!”

3. Cilat janë veprat penale më të shpeshta që kryhen nga të miturit?

Veprat penale më të shpeshta që kryejnë të miturit që vijnë në Institutin e të Miturve Kavajë, janë vjedhjet, si dhe posedimi dhe trafikimi i lëndëve narkotike.

4. A mund të na e përshkruani ditën e parë në Institutin e të Miturve

Kavajë, përballjen tuaj të parë me këta të mitur, jo vetëm nga ana profesionale, por edhe nga ana njerëzore?

Kjo është një pyetje mjaft interesante dhe pa dyshim që do të mundohem ta transmetoj ashtu si unë realisht e përjetova ditën e parë në IM Kavajë.

Në fakt, të shkëputesh nga një qytet ku ke kontribuar ndër vite dhe ta gesh veten në një institucion tjetër, me kolegë të rinj, duke u përballur me të renë, të panjohurën, nuk është e lehtë, por kjo patjetër që përqafohet natyrshëm, me qëllimin e dhënies së më të mirës nga vetja, ideve inovatore që mundohem të transmetoj te kolegët dhe tek i gjithë stafi. Gjithmonë në mendjen time isha duke analizuar kontaktet e para me të miturit, prandaj dhe ditën e parë e vura në funksion të mbledhjes së informacioneve të nevojshme mbi djemtë, të cilët ndodheshin në Institutin e të Miturve Kavajë, numrin e tyre, veprat penale për të cilat akuzoheshin, emrat e tyre, prejardhjen. Të gjithë materialin me informacionet përkatëse e mora me vete ta studioja, pasi të nesërmen do të kisha kontaktin e parë me ta.

Sapo arrita në shtëpi, njoftohem nga specialisti i informacionit se në institucion kishte ardhur një i mitur i ri, “po kryejmë procedurat dhe po njoftojmë oficerin e sigurisë”, - më thanë. Në mendjen time nuk hezitova dy herë të ngrihem dhe të paraqitem sërish në institucion. Vlen të theksohet se procedurat ligjore për çdo hyrje të re kryhen nga komisioni pritës, i cili përbëhet nga një psikolog,

një mjek, një jurist dhe një oficer sigurie, të cilët vlerësojnë rastin me detaje, vlerësojnë dokumentacionin, kryejnë kontrollin shëndetësor, si dhe ajo çka është më e rëndësishmja, ofrojnë mbështetje emocionale të të miturit në konflikt me ligjin. Kur futem në institucion, vërej të gjithë grupin e punës dhe midis tyre qëndronte dhe një djalë, vështimin dhe qëndrimin e të cilit nuk do të mund ta shlyej kurrë nga kujtesa ime. Një djalë i dobët, mesatarisht i gjatë, diku tek 16-17 vjeç, i veshur mirë, me sy të trembur, i cili dukej sikur kërkonte të memorizonte gjithçka që lidhej me atë dhomë, jo vetëm si hapësirë, por edhe me individët përreth. Në pamje dhe në shprehje mendohej të sillej sa më i qetë dhe normal, por fytyra e skuqur dhe lëvizjet e pakontrolluara e tradhtonin bindshëm.

Kolegët bënë prezantimin tim me të miturin, ndërkohë nga media e kisha të mirëdëgjuar rastin. Iu afrova aq sa mund të përcaktohet në hapësirën e sigurisë që ai e diktonte dukshëm, por njëkohësisht u mundova të përcillja tek ai qetësi dhe siguri, të njëjtën gjë ishin duke bërë edhe kolegët e mi ndërkohë.

E ritheksoj, përballja me të panjohurën pas kryerjes së një vepre penale e bën secilin prej nesh të jetë shumë herë më skeptik dhe dyshues në tërësinë e gjësë. Para këtij fakti, bazuar edhe te përgjigjet e tij të ftohta dhe të shkurtra, me “po” ose “jo”, bëj përsëritjen time, ndërhyj dhe e pyes: “-Si ndihesh?”

Përgjigjja e tij, duke pasur parasysh të gjithë interpretimin e mëparshëm ishte: “Mirë, më mirë”, duke fshehur duart me kokën ulur dhe duke bërë lëvizje të vogla, ndoshta të

pavetëdijshe. I afrohem pak dhe e ripyet, më fal të pyeta si ndihesh dhe jo si je? Atë çast mendoj se nuk do ta harroj kurrë. Ngriti kokën, më pa drejt në sy dhe pika loti i vërvitëshin rreth syve, luftoi fort me veten të mos lotonte, por që nuk ia doli dhe përgjigjet: “Si të ndihem, jo mirë, nuk ishte një gjë e mirë ajo që bëra”.

Kaq më mjaftoi që të kuptoja se sa të vështirë, sfiduese dhe profesionale e kam detyrën dhe rolin që më duhet të realizoj dhe konkretizoj çdo ditë me çdo të mitur, me çdo hall të tij, brengë, nevojë, qëndrueshmërinë emocionale, por nuk ka fund se sa kënaqësi merr kur e kryen me sukses këtë sfidë. Arrin të depërtosh brenda qenies njerëzore jo si drejtues, por si njeri, si femër, si nënë.

Ja pra, kjo ishte dita ime e parë e punës dhe që nga ajo ditë arrita t’i them vetes: “Po, ti mund t’ia dalësh!”.

5. A ka disa momente në detyrë, të cilat i veçoni dhe mund t’i ndani me ne, momente të cilat kanë shënuar jetën tuaj, jo vetëm si profesioniste, por edhe nga ana njerëzore?

Çdo moment i bukur në detyrën që përfaqësoj është një punë e gërshtuar me bashkëpunime ndërsektoriale, pa të cilat puna jonë nuk do të jepte të njëjtin rezultat. Patjetër që ka raste ku do të ndalesha. Një prej tyre është përfshirja në aktivitete. E rëndësishme ishte të bindje djemtë që duhet të performonin para të ftuarve, por në çastin kur u përfshinë, nuk donin të ndaleshin më.

Një tjetër moment prekës ishte hartimi i një eseje me rastin e 8 Marsit për festën e gruas. Të gjithë të pranishmit u përloën. Dita e Verës ishte një tjetër emocion që nuk përsëritet. Të miturit krijuan verore

dhe i dhuruan në pritje të dallëndysheve të parë. Një të tillë ma dhuruan edhe mua. Ndërkohë që kaluan ditë, unë e mbaja veroren, sepse, sipas besimeve pagane, ajo duhej hequr kur të shikoje pikërisht dallëndysheve të parë.

Një ditë, njëri prej djemve, të cilin e kam shumë për zemër, më thotë: “-Drejtoresha, mendova se nuk e more seriozisht veroren, por shikoj që ne të gjithë e kemi hequr dhe ti e mban”. Shpjegimi im e gëzoi, sidomos kur theksova se jam në pritje të dallëndysheve. Buzëqeshëm të dy.

Vullnetarizmi i Selmës, vajzës me aftësi ndryshe, përcolli emocion dhe përkujdesje të paparë nga djemtë kundrejt bashkëmoshatares së tyre. Dramatizimi “Dheu është flori”, i rrallë në interpretim dhe pjesëmarrje.

Seanca ndërmjetësuese, ku vetë të miturit u vunë në rolin e gjykatësit, prokurorit, avokatit dhe të pandehurit, përcolli një emocion të ftuarit, por jo vetëm. Së fundmi, janë duke përcjellë mesazhin “Stop luftës në Ukrainë!”. Kur i shikon të angazhuar dhe të përfshirë në realizimin e flamujve të Ukrainës të përcjellin emocion të pafund. Kur ti vëren të gjithë impenjimin, përkushtimin, organizimin e tyre, natyrisht që dhe qasjen dhe ndërveprimin arrin ta kesh shumë herë më njerëzor sesa profesional. Në fund, të gjithë së bashku, jemi një familje e madhe.

6. Si ka ndryshuar qasja juaj nga momenti i parë i kontaktit me të miturit në konflikt me ligjin deri tani?

Shumë herë më njerëzore, shumë herë më tepër mirëkuptuese. Kur ti punon kaq intensivisht me të mitur në konflikt me ligjin, kur shpenzon kaq shumë kohë atje brenda


me ata, arrin të shikosh, të prekësh nga afër personalitetin e secilit, gjendjen emocionale që e karakterizon. Gjatë punës patjetër që shkëmben batuta, jep dhe merr ide. Puna që ne kryejmë me të miturit nuk është thjesht procedurale, përkundrazi, ti je aty për t'i dhënë shumë herë më tepër mbështetje për veprën penale që ka kryer, duke mundur pa pushim konsulta ligjore falas, në mënyrë që të influencojmë pozitivisht sa më shpejt në krijimin e lehtësirave procedurale që lejon ligji. Pra, gjatë gjithë kohës bëhesh një mbështetëse e mirë dhe kurrsesi një gjykuese e veprës penale të kryer prej tij.

7. Cili është mesazhi që do të jepni për të gjithë profesionistët që punojnë me të miturit dhe për vetë të miturit?

Asnjëherë nuk do të rresht së përsërituri: ndërthurja e njerëzores me profesionalen. Ka hapësira të mjaftueshme për të bërë ndasitë e tyre, sikurse ekzistojnë mundësi pa fund për ndërthurjen e tyre.

Trajtimi me dinjitet njerëzor, gërshtuar me etikën profesionale, arrin të thyjë çdo barrierë mosfunksionimi në punën tonë. Asnjëherë nuk duhet harruar çdo rast pranë IM Kavajë, është besim i thyer, një emocion i përjetuar. Pranë IM Kavajë, një fjalë e dhënë,

një vepër penale e kryer, një shfrytëzim i rastit, një mungesë informacioni, një çast, një paaftësi si arsyetim i momentit... ndaj i lutem çdo profesionisti: Bëjeni punën tuaj me pasion, dashurojeni profesionin tuaj, përcillni siguri, dinjitet, integritet te të miturit dhe asnjëherë mos harroni që çdokush duhet të krijojë shpresën dhe besimin e palëkundur që mundet dhe që duhet t'ia dalë! Të mos harrojmë asnjëherë se të gjithë ne mund të jemi një derë e hapur për të bërë të mundur, që ditët e këtyre të miturve të jenë plot dritë dhe plot ngjyra, të gjitha këto bashkë, ndërthuren për të bërë më të mirën e mundshme në punën tonë.



INTERVISTË ME PSIKOLOGEN E IM KAVAJË

1. Sa kohë keni që punoni me të miturit në konflikt me ligjin?

Punën në Institutin e të Miturve Kavajë e kam nisur që në vitin 2019, pra tri vite eksperiencë me të miturit në konflikt me ligjin.

2. Mund të ndani me ne eksperiencën dhe punën tuaj me të miturit në konflikt me ligjin?

Nga eksperiencia ime profesionale, ka qenë një punë sfiduese dhe ajo që më ka rritur më shumë profesionalisht. Është një punë sfiduese sa u takon të gjithë të miturve dhe fushën që trajtohet në veçanti.

Fakti që janë në konflikt me ligjin, e bën më angazhuese dhe sfiduese, por me më shumë përgjegjësi si detyrë, sepse punoj me të mitur që janë në fazën e adoleshencës, janë në kërkim të vlerave njerëzore, familjare dhe janë në periudhën e krijimit të një identiteti dhe në të njëjtën kohë kanë kryer një vepër penale, për të cilën akuzohen nga organet ligjvënëse. Përgjegjësia dhe sfida është shumë e madhe, kjo për t'u dhënë të miturve diçka jo vetëm në aspektin profesional, por edhe atë human dhe emocional ndoshta.

3. Sa bashkëpunues janë me ty?

Në përgjithësi janë bashkëpunues, por sigurisht ka dhe të mitur që kanë rezistencë personale, megjithatë jo të gjithë të miturit janë të njëjtë në këtë drejtim.

Një nga rezistencat më të mëdha që unë shikoj në momentin që ndërmarr një rrugëtim terapeutik me ta, është fakti se shumica prej tyre u ka

munguar një qasje e ngrohtë, emfatike. Ata e kanë të vështirë për të të besuar ndjesitë dhe emocionet e tyre. Fillimisht kanë një lloj rezistence, por me kalimin e kohës, me krijimin e besimit bie. Me ta mund të punosh shumë mirë, mund të bësh punë të mira në aspektin terapeutik, por jo vetëm. Ata mund të kanalizojnë energjitë e tyre, që ndoshta janë drejtuar negativisht për sa i takon veprës penale, por që mund të jenë edhe kreative.

4. Nëse do të dëshironit të ndryshonit diçka në punën tuaj për ta bërë më mirë, çfarë do të ishte?

Puna jonë ka mjaftueshëm gjëra, nuk mendoj se do i shtoja diçka në sensin se është një punë shumë dinamike.

Besoj se në punën me të miturit nuk mund të kesh një rol dhe mjafton, por duhet diçka më shumë për të mos mbetur thjesht një psikologe, por një person, që gjatë këtij rrugëtimi në këtë institucion t'i lë dhe diçka tjetër, përveçse asaj profesionale.

5. Nëse do të jepnit një mesazh për psikologët e tjerë që punojnë me të miturit?

Mesazhi për psikologët është që t'u kushtojnë vëmendje të miturve, sepse nga impakti që kam prej punës së përditshme, por dhe nga kontakti me psikologët e tjerë, kam vënë re që nuk i kushtohet rëndësia e duhur. Adoleshenca është një fazë shpërthyesë dhe një fazë që janë në kërkim të një figure autoritare, të sigurt e më të besueshme dhe besoj se duhet të jemi më të vëmendshëm rreth kësaj kategorie.

6. Po për të miturit?

Të miturit të vazhdojnë dhe të gëzojnë fazën e tyre të rebelimit, sepse duhet. Të gëzojnë me fazën e tyre të kërkimit, eksplorimit, sepse do të vijë një moment që të gjitha gjërat që do të mësojnë do t'u shërbejnë gjithashtu të ndjekin shembuj pozitivë që ju ofrohen, të mësojnë nga to, me qëllim që të kenë një të ardhme më të sigurt dhe të qëndrueshme.

7. Sa ka ndryshuar kjo eksperiencë trevjeçare në bashkëpunim me të miturit dhe qasja juaj si psikologe?

Besoj se puna me të miturit ka pasuruar eksperiencën time profesionale. Në fillimet e saj psikologu mendon se do të jetë ai "psikologu gri", psikologu klasik, që vetëm dëgjon, është neutral dhe mendon se para vetes do të ketë një kliente po të tillë. Ndërkohë, nga puna me të miturit unë kam mësuar se puna e psikologut është një punë ku dy subjektivitetet, pra profesioni im dhe i mituri, bashkëpunojnë vazhdimisht me njëri-tjetrin. Duhet të japësh diçka nga vetja dhe të marrësh diçka nga ata, që procesi terapeutik të funksionojë dhe që në fund të ditës të mendosh se ke bërë një punë të mirë.

8. Ju ka bërë kjo eksperiencë më empatike si njeri dhe të jeni më pak e ftohtë në profesion?

Psikologu duhet të jetë empatik apriori, d.m.th. nuk e bën procesin empatik. Duhet të ruhen kufijtë profesionalë, sigurisht ndërveprimi ka një lloj ndikimi reciprok emocional dhe psikik ndërmjet dy aktorëve, që janë klienti dhe psikologu, diçka e domosdoshme.



INTERVISTË ME TË MITURIN NË IM KAVAJË

1. Si e keni emrin, sa vjeç jeni?

G. K. nga qyteti i Vlorës dhe jam 17 vjeç.

2. Për çfarë jeni akuzuar që ndodheni në IM Kavajë?

Për vrasje. Ndodhi pa dashje, gjatë një konflikti, ishte për vetëmbrojtje.

3. Si ishte dita juaj para se të hynit në IM Kavajë?

Dita ime ishte e bukur, shkoja në shkollë dhe ndiqja vitin e parë gjimnaz.

4. Ju pëlqente shkolla?

Po, më pëlqente.

5. Përveç shkollës, çfarë aktiviteteesh të tjera kishit?

Dilja me shokët.

6. Çfarë menduat ditën e parë kur hytë në institut? Ishte e lehtë të bënit shokë këtu?

E pata të lehtë ambientimin, më kanë mirëpritur dhe jam rehabilituar shpejt.

7. Çfarë do të bëni në momentin e parë që do të dilni jashtë?

Do të vazhdoj arsimin e lartë dhe do të hap biznesin tim, më

pëlqen menaxhimi.

8. Për çfarë ju pëlqen të studioni?

Për matematikë, jam shumë i mirë në matematikë.

9. Cili është mesazhi që do t'u japësh të rinjve?

Të sillen mirë, të mos krijojnë konflikte me njëri-tjetrin, të vazhdojnë shkollën dhe të ndjekin pasionet e tyre.

10. Cili është pasioni juaj, ai që keni pasur para se të vinit në IM Kavajë, ose që ju ka lindur gjatë qëndrimit këtu?

Pasion kam pasur menaxhimin, përveç matematikës kam qejf edhe të menaxhoj, menaxhim biznesi.

11. Nëse do ktheheshit pas në kohë, çfarë do të bënit ndryshe?

Nuk do të konfliktohesha me njerëzit, do të përpiqesha ta shmangia.

12. Nëse do të ishit duke ecur në rrugë tani dhe shikoni një moshatar që është gati të bëjë të njëjtin veprim që bëtë ju, çfarë do

të bënit, si do të reagonit?

Do ta ndaloja, do t'i flisja, do t'i thosha të mos e bënte, sepse nuk ka kthim pas.

13. A keni reflektuar gjatë qëndrimit në IM Kavajë?

Kam reflektuar, është normale që këtu brenda do të mësosh. Mendoj se kam ndryshuar, jam rritur në mendime dhe jam ndier komod gjatë qëndrimit tim, kam pasur mbështetjen e nevojshme.

14. Si e kaloni kohën? Çfarë aktiviteteesh ju pëlqen të bëni? Ku aktivizoheni më shumë?

Zgjothem në mëngjes, shkojmë në shkollë. Më pas, pasdite merremi me aktivitete të ndryshme, si futboll.

15. Do të na jepni një mesazh për ta përmbyllur, çfarë ka ndryshuar tek ju gjatë qëndrimit këtu?

Kur u futa këtu isha 15 vjeç, tani jam 17. Perspektiva ime për të ardhmen është e njëjta si ajo që mendoja kur isha jashtë, të vazhdoj arsimin e lartë dhe pastaj të kem bizneset e mia.

Ti ke të drejtë të
trajtohesh me respekt
dhe dinjitet!



Rruan:

- Lorena
- Aneta
- Briona
- Arbër

INTERVISTË ME TË MITURIN NË IM KAVAJË

1. Sa vjeç jeni?

17 vjeç.

2. Para se të hynit në IM Kavajë, si ishte dita juaj? Me se merreshit?

Isha në punë, kaloja një pjesë të madhe të kohës aty, pastaj gjatë darkës dilja me shokët.

3. Çfarë pune bënit? Të pëlqente puna që bënit?

Isha marangoz. Po, më pëlqente, e kam dhe pasion.

4. Ditën e parë që hytë në Institutin e të Miturve, çfarë menduat? Ishte e lehtë të bënit shokë këtu?

Nuk ishte e lehtë, me kalimin e kohës ambientohesh dhe me vendin dhe me njerëzit.

5. Si e kaloni ditën? Çfarë aktiviteteesh ju pëlqen të bëni? Ku ju pëlqen të aktivizoheni më shumë?

Kemi aktivitete të ndryshme, në fillim është shkolla. Fizkultura është një nga lëndët që më pëlqen më shumë, pastaj pasdite kemi aktivitete të tjera, si futboll, palestër, kompjuter, ndonjëherë vijnë edhe shoqata nga jashtë që bëjnë aktivitete, si lojëra me letra, me top aktivitete të këtij lloji.

6. Ju kanë folur për mundësi punësimi kur të dilni nga IM Kavajë?

Po, më kanë treguar se pasi të dal nga instituti mund të shkoj të punoj si marangoz në Tiranë.

7. Jashtë ju keni punuar marangoz, po këtu keni ndjekur kurse për marangoz?

Po, normal që po.

8. Nëse do të ishit duke ecur në rrugë tani dhe shikon një moshatar që është gati të bëjë të njëjtin veprim që ju keni bërë, çfarë do të bënit, si do të reagonit?

Do të përpiqesha që ta ndaloja.

9. Cili është mesazhi që do u jepnit bashkëmoshatarëve?

Të mos bëjnë gabimin që bëra unë, sepse mund të vijnë këtu (IM Kavajë).

10. Çfarë keni reflektuar gjatë gjithë qëndrimit tuaj në Institutin e të Miturve Kavajë?

Kam kuptuar atë që kam bërë, tani frikësohem të bëj ndonjë gjë tjetër, i kuptoj pasojat.

11. Nëse do të ktheheshit pas në kohë e të bënit një rezymë të jetës tuaj para dhe gjatë qëndrimit në IM Kavajë, çfarë do të ndryshonit? Si e mendoni jetën pasi të dilni nga IM Kavajë?

Jeta ime do të jetë ndryshe, çdo gjë ka ndryshuar. Gjatë kësaj periudhe të qëndrimit tim këtu kam marrë disa certifikata, që mund të më hyjnë në punë.

Gabimet që kam bërë, nuk do të bëhen më.

12. Si mendoni se do të jetë pasi të dilni që këtu, do

t'i ruani marrëdhëniet me shokët që keni njohur, ose punonjësit?

Po, po, jam ndier shumë i mirëpritur këtu.

13. Cila është gjëja e parë që do të bëni sapo të dilni nga Instituti i të Miturve Kavajë?

Qëndrimi në shtëpi, të paktën disa ditë, pastaj se di, do rifilloj punën.

14. Çfarë ju mungon më shumë nga jeta juaj para hyrjes në Institut?

Më mungojnë shumë gjëra, njohja këtu me një shok është ndryshe, njohja jashtë është ndryshe.

15. A keni pasur shoqëri jashtë? A kanë ardhur t'ju vizitojnë, ose t'ju dërgojnë mesazhe?

Po, kam shoqëri jashtë dhe kanë ardhur, disa po.

16. Çfarë mendojnë ata për ty tani? Kanë ndryshuar mendim, apo të përkrahin, të mbështesin?

Jo, më përkrahin më thonë mos u mërzhit se do të kalojë.

17. Çfarë mesazhi do të përcillni tani për të gjithë bashkëmoshatarët e tu, apo ata që janë në konflikt me ligjin?

T'u shmangen veprimeve që mund t'ju sjellin në këto institucione të tilla, që janë të ndaluara nga ligji.

INTERVISTË ME PUNONJËSEN E MBROJTJES SË FËMIJËS ELBASAN, NADIRE KREKA

Prej 18 vitesh punoj si punonjëse e Mbrojtjes së Fëmijëve e në vazhdim përgjegjëse Sektori për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Barazinë Gjinore pranë Drejtorisë së Shërbimeve Komunitare dhe Kujdesit Social në Bashkinë Elbasan.

Puna ime është e fokusuar veçanërisht në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, mbështetjen e Punonjësve për Mbrojtjen e Fëmijëve në Njësitë Administrative të Bashkisë Elbasan, në procesin e menaxhimit të rasteve, por edhe në menaxhimin e stafit të sektorit.

Sa sfiduese është të punosh me të miturit në konflikt me ligjin?

Mbrojtja e fëmijëve është një proces sfidues, pasi kërkon një qasje multidisiplinare dhe ndërsektoriale dhe si e tillë kërkon angazhimin dhe bashkëpunimin e të gjitha strukturave agjencive përgjegjëse. Për të pasur një qartësi mbi rolin e punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, dua të sqaroj se kur fëmija nën moshën e përgjegjësisë penale hyn në konflikt me ligjin, rasti i tij menaxhohet vetëm në rrugë civile dhe punonjësi për mbrojtjen e fëmijës është në rolin e menaxherit të rastit, i cili kryen këtë funksion që nga identifikimi i rastit deri në mbylljen e tij.

Rasti i të miturit në konflikt me ligjin në moshën e përgjegjësisë penale menaxhohet nëpërmjet rrugës penale. Roli i Punonjësit për Mbrojtjen e Fëmijës gjatë fazës së hetimeve dhe gjyqimit është orientues dhe këshillues

për një sërë profesionistësh. Sfidat në trajtimin e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin janë të shumta, por kryesisht për sa i përket parandalimit dhe rehabilitimit. Fenomeni i përsëritjes së krimeve nga të miturit lidhet me sjelljen e sistemit të drejtësisë, shoqërisë dhe familjes ndaj tyre. Nevojat e të miturve duhet të jenë udhërrëfyes për veprimtarinë e të gjithë zinxhirit të institucioneve përgjegjëse, si dhe organizatave që merren me drejtësinë për të miturit.

Si mendoni se mund të ishte më i mirë procesi i rehabilitimit?

Mendoj se një proces i suksesshëm rehabilitimi ka në qendër të miturin, prandaj sugjeroj me forcë përfshirjen e të miturit në proces, duke bërë pjesë të planit të rehabilitimit nevojat, dëshirat dhe mundësitë e të miturit.

Me krijimin e QPKMR, e cila është një strukturë që ka për qëllim mbikëqyrjen dhe mbrojtjen e të miturit pas kryerjes së dënimit, bashkëpunim midis strukturave përgjegjëse si IEVP, Shërbimin e Provës, NJMF dhe institucione të tjera, përfshirjen e të miturit dhe familjarëve kur kjo është e mundur, në hartimin e planit të rishoqërizimit dhe rehabilitimit të të miturit, mendoj se procesi ka garanci të jetë i suksesshëm.

Cili është roli i familjarëve në këtë proces, a kanë bashkëpunues?

Familja ka një rol të pazëvendësueshëm në parandalimin dhe rehabilitimin e rasteve të të miturve në konflikt me ligjin. Gjatë trajtimit

të rasteve të të miturve, kemi pasur raste kur familja ka qenë mjaft mbështetëse në rehabilitimin e të miturit, por fatkeqësisht ka pasur dhe raste të konsiderueshme, kur familjarët jo vetëm që nuk bashkëpunojnë, por janë krejtësisht indiferentë, gjë që e ka vështirësuar punën në trajtimin e rastit.

Ajo që mund të them me siguri është se familja përbën një faktor të rëndësishëm, veçanërisht në rehabilitimin dhe në mosrecidivizmin e të miturve.

Nëse do të jepni mesazh për aktorët e tjerë që punojnë me të miturit në konflikt me ligjin, cili do të ishte ai?

Mendoj se kemi shumë për të bërë drejt një sistemi drejtësie sa më miqësor për të miturit. Ajo që shikoj të rëndësishme, është të rrisim kapacitetet e profesionistëve të çdo hallke të zinxhirit të mbrojtjes së fëmijëve dhe drejtësisë penale. Shërbimet e shtuara që ndikojnë në parandalimin e fenomenit të të miturve në konflikt me ligjin si edhe atë të recidivizmit, diversifikimin e shërbimeve riintegruese për të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, siç janë mundësitë e punësimit, formimit profesional apo të aktiviteteve rekreative. Pra, është e rëndësishme të kuptohet nga të gjithë se në trajtimin e rasteve për të miturit në konflikt me ligjin nuk mund të ketë më ndërhyrje të veçuara, por me tërë zinxhirin e institucioneve përgjegjëse, që nga policia dhe deri tek institucionet që shërbejnë për rehabilitimin e trajtimin e kësaj kategorie.

INTERVISTË ME PROKUROREN SILVANA LULE

1. Prezantimi juaj hyrës

Quhem Silvana Lule, prej 14 vitesh punoj në sistemin e drejtësisë. Që prej vitit 2013 punoj si prokurore në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë me çështje që lidhen përgjithësisht me të miturit në konflikt me ligjin, dhunën në familje etj.

2. Sa të shpeshta janë rastet që trajtoni ju lidhur me të miturit në konflikt me ligjin?

Në punën time të përditshme çështjet që trajtojnë të miturit në konflikt me ligjin janë shumë të shpeshta. Ata përfshihen në veprimtari të ndryshme në kundërshtim me ligjin si: episode dhune, drejtim i mjetit pa leje drejtimi të duhur, si dhe abuzime me substancat. Të miturit i përkasin përgjithësisht grupmoshës 14-18 vjeç, por nuk mungojnë edhe rastet nën 14 vjeç.

3. Sa sfiduese është për një prokuror të ngrejë akuzën për një çështje, ku në të është i përfshirë një i mitur?

Për një prokuror është mjaft sfiduese të ngrejë një akuzë për çështje ku përshihen të mitur. Në raste të tilla nuk është sfiduese vetëm pjesa

me të miturin, por fakti që në këto çështje përshihet e gjithë familja. Moshë e vogël e të pandehurve të mitur, e kërkon patjetër prezencën e prindit dhe shpeshherë gjendja emocionale e familjarëve është e rënduar, gjë që kërkon patjetër një trajtim të veçantë të çështjeve. Por, në këto raste, patjetër që duhet të jemi sa më objektivë dhe të realizojmë një hetim cilësor dhe të plotë.

4. A janë të gatshëm të miturit të bashkëpunojnë me drejtësinë dhe cila është qasja që kanë?

Në rastet kur kemi të mitur në konflikt me ligjin, në shumicën e rasteve të miturit janë të gatshëm të bashkëpunojnë me drejtësinë. Kjo gjë ndodh përgjithësisht te të miturit që kryejnë një vepër penale për herë të parë. Pasi iu është shpjeguar procesi penal, pasojat që ka vepra penale që mund të kenë kryer, pjesa më e madhe është patjetër e gatshme që të bashkëpunojë që masa e marrë ndaj tyre të jetë më e lehtë. Një pjesë e konsiderueshme shfaqin edhe pendesë gjatë procesit penal.


5. Cili është mesazhi juaj për aktorët e tjerë që punojnë

me të miturit në konflikt me ligjin?

Të gjitha institucionet ose organizatat, të cilat punojnë me të miturit, duhet të ofrojnë shërbime sa më cilësore për ta. Në çdo çështje duhet të orientohen nga interesi më i lartë i fëmijës, të fokusohen në potencialin e të miturve dhe në fuqizimin e rolit të familjes. Nëse një i mitur në konflikt me ligjin trajtohet në mënyrë cilësore, nëse trajtohet edhe familja në mënyrë tërësore, gjasat që ai të kryejë një vepër penale në të ardhmen janë më të pakta.


6. Cili është mesazhi që doni të përcillni për lexuesit e kësaj reviste?

Së pari, ju falënderoj për intervistën. Për të gjithë lexuesit e kësaj reviste shpresoj që përmes leximit të përjetimeve individuale të të miturve, të gjithë të vendosim veten në pozicionin e tyre përpara se të gjykojmë për një çështje të caktuar. Gjithashtu, pse jo, le të shërbejnë të gjitha këto mesazhe si mjete parandaluese për përfshirjen e të miturve në vepra, të cilat janë në kundërshtim me ligjin.



Drejhtësia
do të jetë
më e shtë
me
ty!

Jeta jote
private është
e mbrojtur!



INTERVISTË ME PRINDIN E TË MITURIT NË KONFLIKT ME LIGJIN

1. Si u ndiet kur u njoftuat se fëmija juaj ka kryer një veprë penale?

Sigurisht që nuk u ndjeva mirë, isha e habitur dhe e tronditur, pasi nuk është e lehtë për një prind të marrë lajme të tilla për fëmijën e tij. Për momentin u ndjeva shumë keq, mblodha veten dhe thashë do i bëj ballë e do ta mbështes fëmijën tim që të dalë nga kjo situatë, pavarësisht rrethanave dhe arsyeve që e kanë shtyrë që fëmija im të jetë në konflikt me ligjin.

Falë ndihmës së policisë, gjykatës, psikologut dhe punonjësit të mbrojtjes së fëmijës në qytetin ku ne banojmë, djali im dhe sjellja e tij është përmirësuar dukshëm; ai e ka kuptuar që veprimet e tij nuk janë etike dhe dalëngadalë po i kthehem normalitetit dhe jetës larg problemeve me ligjin dhe veprave penale.

2. Ju kishit avokat, apo ju ofruan një të tillë?

Pasi fëmija im u gjend në konflikt me ligjin, sigurisht që kontaktua me një avokat që të na përfaqësonte dhe të na tregonte procedurat ligjore, të cilat djali im dhe unë si nëna e tij, duhet të ndiqnim, për të marrë një vendim të drejtë në proporcion me veprën penale që im bir kishte kryer.

3. Sa e lehtë ka qenë përshtatja në komunitet për ju dhe fëmijën tuaj pas daljes nga Kavaja? Ishte e vështirë faza pas daljes nga Kavaja?

Sigurisht që nuk ishte aspak e lehtë të gjendesh në një situatë të tillë, aq më tepër në një qytet të vogël, siç është qyteti ku ne banojmë aktualisht, ku paragjykimi dhe diskutimet janë

pjesë e përditshmërisë sonë, e për më tepër gjendja në një situatë të tillë e bënte akoma dhe më të vështirë përballjen me njerëzit, qoftë timen si nënë, ashtu edhe të djalit tim si autor i një veprë penale. Gjithashtu, duke u gjendur në një situatë të tillë, gjëja e fundit që mund të mendoja ishin paragjykimet e njerëzve përballë mirëqenies dhe rikthimit të fëmijës tim në jetën normale që kishte para vuajtjes së dënimit në Institutin e të Miturve Kavajë.

4. Po për fëmijën si ka qenë, si e ka përjetuar ai këtë situatë dhe të gjithë ngjarjen?

Djali nuk e pati të lehtë, pavarësisht situatës dhe rrethanave që e detyruan atë të ishte në konflikt me ligjin. Vlen të theksohet fakti se, im bir u përkrah dhe u mirëprit mirë nga shoqëria dhe shkolla në të cilën ai vazhdon studimet. Shoqëria dhe stafi i mësuesve e mirëpritën, madje për habinë tonë, im bir po trajtohej ndoshta edhe më mirë se më parë.

5. Si ka qenë marrëdhënia juaj me institucionet?

Ju kanë kontaktuar nga komisarati, psikologu ka qenë afër?

Ndihma më është ofruar në çdo ambient ku kam shkuar. Më kanë udhëzuar, më kanë treguar se cilat janë të drejtat e mia dhe çfarë procedurash ligjore duhet të ndjek, si duhet të përkujdesesha për djalin tim në këtë situatë delikate, dhe se si duhet të veproja konkretisht që mos ta bëja tim bir të ndihej edhe më fajtor apo i gjykuar për veprimin që kishte bërë, kështu që jam e kënaqur me

të gjitha institucionet që më kanë mbështetur dhe ndihmuar përgjatë gjithë periudhës së qëndrimit të djalit tim në IM Kavajë, ashtu dhe pas daljes nga aty.

6. Po mesazhi që donit të jepni për familjet e tjera që ndodhen, apo kanë qenë në të njëjtën situatë si ju?

Në radhë të parë më vjen keq për të gjitha nënat që gjenden në të njëjtën situatë, apo situatë të ngjashme si kjo imja. Dëshira ime është që çdo nënë të bëhet e fortë, sepse në jetë ka shumë vështirësi dhe shumë gabime mund të ndodhin. Fëmijët mund të gabojnë për arsye nga më të ndryshmet, ajo që është e rëndësishme, është që pas këtyre gabimeve ata të marrin një mësim dhe ne si prindër të jemi mbështetja e tyre më e madhe.

Gjithashtu, dua të theksoj për të gjithë prindërit, që të komunikojnë sa më shumë me fëmijët e tyre, për çdo gjë, vetëm në këtë mënyrë do të mund të parandalojmë situata të tilla dhe pasojat që ato sjellin më pas, fundja kush e njeh fëmijën e tij më mirë se prindi!

7. Dëshironi të shtoni një gjë tjetër, apo të jepni një mesazh?

Mesazhi im është që, të gjithë ne si shoqëri që ndodhemi në situata të tilla, apo shohin një të mitur, i cili ndodhet në një situatë ndryshe nga bashkëmoshatarët e tij, apo në konflikt me ligjin, të jenë më empatik, më të ndjeshëm dhe ta bëjnë veten më të guximshëm, më të butë në shpirt për ta afruar në shoqëri dhe në grup, për t'i ardhur në ndihmë këtij të mituri.

INTERVISTË ME OFICEREN I SIGURISË, GJIMNAZI “SAMI FRASHËRI”, TIRANË

1. Prezantimi juaj hyrës

Quhem Xhesika Grëmi, prej tri vitesh oficerë sigurie në gjimnazin “Sami Frashëri” Tiranë.

Ndiej përgjegjësinë profesionale dhe detyrimin moral, për të krijuar përherë ambiente të sigurta brenda dhe jashtë perimetrit të shkollës, duke u ofruar nxënësve një klimë të ngrohtë e mbështetëse gjatë procesit mësimor-edukativ dhe duke forcuar çdo ditë bashkëveprimin midis shkollës, prindërve dhe nxënësve.

2. Cili është roli i oficerit të sigurisë në shkollë?

Në zbatim të Ligjit Nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Vendimit Nr. 600, datë 9.10.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e shërbimit të sigurisë publike në 150 institucione të arsimit parauniversitar dhe të kriterëve për oficerët e sigurisë”, Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë “Për Oficerët e Sigurisë në Shkollat Publike”, Urdhrit Nr. 531, datë 14.09.2018 të MASR “Për ngritjen e zyrës së koordinimit dhe monitorimit të marrëveshjes së bashkëpunimit me Ministrinë e Brendshme për oficerët e sigurisë në shkollat publike”, Ligjit Nr. 69/2012 “Për arsimin parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe të Urdhrit Nr. 31, datë 28.01.2020 “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”, po ju listoj detyrat dhe përgjegjësitë

që ka oficeri i sigurisë gjatë ushtrimit të detyrës së tij pranë Institucionit Arsimor, si më poshtë vijon:

- Monitoron mjedisin e shkollës në mënyrë të vazhdueshme, rreth situatave të dyshimta, hyrjes së personave të paautorizuar apo cenimit të pronës së shkollës;
- Ofron një prani të dukshme dhe të aksesueshme brenda shkollave dhe më gjerë në komunitet;
- Punon me shkollat për përmirësimin e nivelit të ndërgjegjësimit për problematika si: përdorimi i drogës, bullizmi, siguria në internet, pasoja e dhunës dhe krimit;
- Parandalon dhe menaxhon rastet emergjente dhe të dhunës në shkollë;
- Kontribuon në ndërgjegjësimin e nxënësve për rregullat, ligjin dhe drejtësinë;
- Merr pjesë në takimet me prindër dhe në takime periodike të stafit pedagogjik të shkollës për evidentimin e problematikave dhe diskutimin e zgjidhjeve për sigurinë në shkollë, sa herë kërkohet nga drejtori i shkollës;
- Bashkëpunon me drejtorinë e shkollës dhe stafin pedagogjik, për të garantuar dhe krijuar një mjedis të sigurt në shkollë;
- Ndërvepron me drejtorinë e shkollës dhe me stafin e saj duke ndërhyrë dhe parandaluar në rastet e thyerjes së disiplinës, menaxhimit të krizave dhe në rastet e emergjencave;
- Krijon një plan sigurie të shkollës, duke përcaktuar rreziqet e mundshme, daljet emergjente dhe duke minimizuar burimet e aksidenteve;
- Bashkëpunon me agjencitë ligjzbatuese dhe shërben si ndërlidhës mes Policisë së Shtetit dhe komunitetit, me qëllim parandalimin e veprave kriminale;
- Evidenton situatat e parregullta të rendit dhe të sigurisë publike, brenda dhe jashtë perimetrit të shkollës dhe njofton oficerin e policimit në komunitet;
- Shërben si oficer raportues dhe menaxhues, i situatave, të cilat mund të paraqesin një rrezikshmëri në mjediset e shkollës;
- Bashkëpunon dhe ndërmjetëson me punonjësin e shërbimit psiko-social në situata konfliktuale brenda mjediseve të shkollës;
- U ofron prindërve asistencë për zgjidhjen e situatave të ndryshme dhe për menaxhimin e konflikteve.
- Përshtatet me komunitetin e zonës në të cilën ndodhet shkolla ku do të ushtrojë veprimtarinë kudo të veprojë.
- Realizon takime informuese me nxënësit, stafin pedagogjik dhe prindërit, për rastet që paraqesin rrezikshmëri shoqërore, me qëllim që të rrisë ndërgjegjësimin qytetar;
- Harton raporte javore, vjetore dhe të situatës/incidentit, të cilat do t’ia dërgojë Zyrës për Koordinimin dhe Monitorimin;

- Raporton në mënyrë periodike pranë autoriteteve përgjegjëse (Njësi Arsimore Vendore, Zyrës së Koordinimit dhe Monitorimit pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit), sipas formateve të miratuara të raportimit;
- Zbaton parimet etike për ruajtjen e konfidencialitetit të rasteve të veçanta dhe sensitive;
- Zhvillon kontrolle fizike të nxënësve ose të mjediseve, vetëm në raste emergjente ose me vendim nga drejtoria e shkollave.

Duhet theksuar se, në vëmendje mbetet fakti se oficeri i sigurisë nuk zëvendëson rolin e mësuesit apo aktorëve të tjerë të shkollës në lidhje me mbikëqyrjen, kujdesin, rregullin dhe disiplinën, brenda dhe jashtë shkollës. Oficeri i sigurisë, gjithashtu, nuk ndërmerr masa disiplinore, por raporton çdo shkelje të disiplinës në shkollë pranë drejtorisë së shkollës.

Puna e oficerit të sigurisë konsiston në monitorimin e vazhdueshëm brenda dhe jashtë territorit në institucionin arsimor, ku në këtë mënyrë identifikon dhe parandalon raste të konflikteve, të cilat mund të lindin midis bashkëmoshatarëve me njëri-tjetrin, duke bashkëpunuar ngushtësisht me drejtorinë e shkollës dhe oficerin e policimit në Komunitet, i cili është përgjegjës për shkollën përkatëse.

3. A janë të shpeshta rastet e të miturve në konflikt me ligjin në shkollën tuaj?

Gjimnazi “Sami Frashëri” Tiranë, është një shkollë elitare, që punon çdo ditë fort dhe me profesionalizëm për sigurinë dhe qetësinë e nxënësve, ku drejtoria e shkollës, së bashku me aktorët mbështetës, kontribuon në mbarëvajtjen e procesit mësimor-edukativ për

nxënës të qetë dhe mjedise të sigurta. Rastet në konflikt me ligjin për shkollën tonë janë të pakta.

4. A mund të ndani me ne eksperiencën tuaj lidhur me të miturit në kontakt/konflikt me ligjin në shkollë?

Duke iu referuar statistikave të deritanishme, mund të themi se nxënës/të mitur në konflikt me ligjin pranë gjimnazit tonë janë dy (njëri prej tyre shpërngulur nga shkolla në fund të periudhës së dytë të këtij viti shkollor dhe regjistruar në një qytet tjetër për arsye familjare).

Në praktikën e saj, shkolla në bashkëpunim me Drejtorinë e Policisë dhe komisaritet përkatëse, evidenton dhe raporton pranë nesh çdo shkelje të të miturve që bien në konflikt me ligjin dhe anasjelltas. Kur evidenton incidente, që janë në konflikt me ligjin, shkolla, në bazë të legjislacioneve në fuqi raporton në komisaritet përkatëse duke ezauruar paraprakisht edhe vetë të gjitha detyrat që ligji i njeh me nxënësit/të miturit në konflikt me ligjin. Profesionalizmi, njohja e zbatimi shumë i mirë i ligjshmërisë dhe bashkëpunimi i ngushtë që shkolla ka me prindërit e nxënësve, veçanërisht i drejtoreshës sonë, znj. Majlinda Ziu, ka bërë të mundur, që në ndonjë situatë të ndërlikuar dhe ardhur nga jashtë mureve të shkollës, të eliminohet, si dhe të zbuten sjellje devijante, negative të ndonjë nxënësi që bie në konflikt me ligjin, në mënyrë që ato të mos kenë ndikime brenda shkollës dhe të mos cenohet siguria e mirëqenia e nxënësve. Kështu, në rastin e një prej të miturve në konflikt me ligjin (me vendim të formës së prerë) O. S. dhe shkollës i është rritur shkalla e vështirësisë në edukimin/ndërgjegjësimin të miturit,

mbikëqyrjen dhe vëzhgimin e vazhdueshëm të ecurisë së tij dhe të raportit të tij me bashkëmoshatarët. Në rastin tjetër (tashmë të shpërngulur në një shkollë të mesme të një qyteti tjetër), vështirësia ka qenë e lidhur me sigurimin e vazhdimësisë së procesit mësimor-edukativ (i cili u ofrua online gjatë kryerjes së dënimit), ruajtjen e ekuilibrave dhe të sigurisë për bashkëmoshatarët e klasës së tij, rehabilitimin e nxënësit pas ndryshimit të masës së sigurisë etj.

5. A ka ndikuar prania e një oficeri sigurie në shkollë në uljen e rasteve konfliktuale të të miturve në shkollë?

Sigurisht, figura e oficerit të sigurisë ka shërbyer si një urë lidhëse midis institucionit arsimor, familjes, komunitetit dhe Policisë së Shtetit, ku si pasojë e mirëfunksionimit të këtij zinxhiri, është arritur zbutja e fenomeneve me natyrë negative si (përdorimi i substancave narkotike, bullizmit fizik e verbal, krimet kibernetik, posedimit të armëve të ftohta etj.). Edhe statistikave të incidenteve në vitet e fundit, dëshmojnë se oficeri i sigurisë ka krijuar urën e bashkëpunimit me nxënësit, për identifikimin e rasteve që në gjenezë dhe mosaggravimin e tyre në konflikte madhore, çka për ne si shkollë, kjo është një arritje. Shkolla të sigurta, prindër dhe nxënës të qetë!

Të masësh punën me uljen e numrit të incidenteve për mua si oficer sigurie është një arritje që nga fillimi i punës në këtë profesion.

6. Sa sfiduese është të punosh me të miturit në konflikt me ligjin?

Të punosh me adoleshentë është sfiduese, ndërkohë që të punosh me adoleshentë në konflikt me ligjin është akoma

më sfiduese dhe e vështirë,
pasi kujdesi i treguar ndaj
tyre duhet të jetë shumëfish
më i lartë, sesa me nxënësit
në përditshmëri. Gjithashtu,
vëzhgimi në ambientet brenda
shkolle dhe jashtë saj, bëhet
me i vështirë kur një nxënës/i
mitur në konflikt me ligjin është
mes të miturve që zhvillojnë

procesin mësimor të rregullt
dhe me sjellje shumë të mira.
Edhe mjedisi jashtë shkolle
dhe shoqëria, që i mituri në
konflikt me ligjin ka, është
sfidë për mua si oficer sigurie
në monitorimin dhe vëzhgimin
e përditshmërisë, kjo bazuar
edhe në ngarkesën që shkolla
ka në përditshmërinë e saj,

por me bashkëpunimin e të
gjithë aktorëve që kontribuojnë
për shkollë të sigurt, ka bërë
të mundur mirëmenaxhimin
e rasteve të nxënësve/të
miturve në konflikt me ligjin,
në mënyrë që ata të kenë
kujdesin maksimal, mbikëqyrje
të posaçme dhe mosdiferencim
nga bashkëmoshatarët e tyre.

ÇDO KUSH MERITON
NJË SHANS
TË DYTË!



TELEFONO.
ALO 116 111

Punuan: Klejdi Demiri
Monika Musta
Era Makri
Andrea Dalipi
Aleksander Josifi

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS.

INTERVISTË ME DREJTORESHËN, ZNJ. PATRICIA POGAÇE

1. Prezantimi juaj hyrës...

Unë quhem Patricia Pogaçe. Që prej nëntorit të vitit 2020 jam e emëruar në pozicionin e drejtorit në Drejtorinë e Zbatimit të Politikave dhe Administrimit të Ndhmës Parësore në Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një institucion i ri, i krijuar me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili ka për qëllim garantimin e shërbimit ligjor falas për kategoritë në nevojë. Fillimisht më lejoni t’ju falënderoj për ftesën, si dhe t’ju përgëzoj për këtë nisëm mjaft inovatore për administratën publike.

2. A keni trajtuar raste të të miturve në konflikt me ligjin?

Mbrojtja e interesit më të lartë të fëmijëve është një nga parimet themelore, i cili bën bashkë të gjitha institucionet qendrore, vendore, të pavarura, organizatat e shoqërisë civile etj., pavarësisht nëse është ose jo detyrë e tyre funksionale sipas ligjeve organike. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas është një institucion i ri, i krijuar de facto në vitin 2020, vit në të cilin jemi përballur me shumë sfida, ku më kryesorja ishte pa dyshim pandemia Covid-19. Viti 2021 ishte një vit shumë aktiv për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas, ku në një kohë të shkurtër është realizuar një punë intensive në kuadër të ngritjes së një skeme efektive të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Përgjatë një viti u ngritën 10 (dhjetë) qendra të

shërbimit të ndihmës juridike parësore në Tiranë dhe rrethe, të cilat administrohen dhe monitorohen nga Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas. Gjithashtu, janë autorizuar për herë të parë 12 (dymbëdhjetë) organizata jofitimprurëse të autorizuar nga Ministria e Drejtësisë (disa prej tyre të specializuara në ofrimin e shërbimit ligjor falas për të miturit), si dhe janë lidhur 12 (dymbëdhjetë) marrëveshje bashkëpunimi me Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë.

Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, në referim të nenit 11 të tij, tashmë i ka cilësuar të miturit si subjekte të posaçme, që, pavarësisht nga të ardhurat e tyre, janë përfitues të drejtpërdrejtë të ndihmës juridike parësore e dytësore dhe konkretisht:

- Të miturit, viktimat të dhunës në familje;
- Të miturit, viktimat të abuzimit seksual dhe të miturit, viktimat të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- Viktimat e mitur dhe të miturit në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- Fëmijët që jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- Fëmijët nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor.

Duke ritheksuar edhe njëherë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijëve, forcimi

i kapaciteteve përmes përmirësimit të kuadrit profesional është një ndër prioritetet që Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka në funksion të garantimit të një shërbimi juridik eficient dhe cilësor. Për këtë qëllim, drejtoria është në bashkëpunim të vazhdueshëm me partnerë ndërkombëtarë, të cilët mbështesin Ministrinë e Drejtësisë dhe Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas përmes implementimit të projekteve të ndryshme në këtë kuadër. Për të vijuar me pyetjen konkrete, po, të miturit në konflikt me ligjin kanë përfituar nga skema e ndihmës juridike parësore dhe dytësore. Konkretisht, për periudhën 2020 - 2021, 403 të mitur kanë përfituar ndihmë juridike parësore dhe dytësore. Këta të mitur kanë qenë përfitues, qoftë në cilësinë e të miturve në konflikt me ligjin, ashtu edhe në cilësinë e viktimave të mitur. Theksojmë se, në kushtet kur ligji për ndihmën juridike është një ligj i ri, nevojitet fillimisht një vëmendje e shtuar në kuadër të promovimit të të gjithë sistemit në tërësi. Këtë qëllim ka pasur edhe DNJF përmes aktiviteteve të zhvilluara përgjatë viteve 2020, 2021 dhe 2022. Rritja progresive e numrit të përfituesve është një tregues, që ndihma juridike është duke u njohur nga qytetarët, por pa dyshim nevojitet akoma më shumë punë dhe angazhim nga institucionet përgjegjëse, që kjo ndihmë të jetë sa më pranë qytetarëve. Sfidë për Drejtorinë e Ndhmës Juridike Falas është rritja e kërkesave për ndihmë juridike me subjekte

të miturit përmes zhvillimit të sa më shumë aktiviteteve ndërgjegjëse/informuese me këtë target grup, si dhe publikimit të materialeve të ndryshme të vizibilitetit, me qëllim promovimin e sistemit të ndihmës juridike dhe të së drejtës për të përfituar falas nga këto shërbime ligjore.

3. Gjatë punës suaj me të miturit në konflikt me ligjin, a shfaqin ata pendesë dhe reflektojnë për veprimin që kanë kryer? Dhe, në intuitën tuaj, a mendoni se të miturit pendohen realisht për veprimin që kanë kryer?

Personalisht, një ndër aktivitetet që më ka lënë mbresa përgjatë ushtrimit të detyrës sime, ishte aktiviteti Akses në drejtësi për të miturit në konflikt me ligjin, i cili u zhvillua, me qëllim ndërgjegjësimin e të miturve pranë Institutit të të Miturve, Kavajë. Përgjatë këtij aktiviteti, përfaqësuesit e ndihmës juridike falas patën mundësinë të bashkëbisedonin me të miturit e këtij instituti, duke i shpjeguar në mënyrë të thjeshtëzuar se si ata, apo prindërit e tyre, mund të përfitonin nga shërbimet ligjore

falas. Përgjatë aktivitetit, jo vetëm që këta të mitur shfaqën një vëmendje dhe interes të madh për t'u informuar mbi mënyrën e përfitimit të këtij shërbimi, por njëkohësisht përgjatë bashkëbisedimit me ta, shfaqej në formë të theksuar pendesa dhe dëshira që ata kishin për t'u riintegruar në komunitet.

Të qenët në kontakt të drejtpërdrejtë me të miturit, në konflikt me ligjin, vendos në pah rëndësinë e komunikimit empatik dhe mbështetjen e tyre pa treguar paragjykim. Kjo ndihmon në krijimin e një ure bashkëpunimi në drejtim të pendesës, fitimit të besimit dhe integritetit të tyre në shoqëri.

4. A është e vështirë puna juaj në mbrojtjen e të miturve në konflikt me ligjin?


Ofrimi i shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe dytësore është një sfidë për juristët dhe avokatët e Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Duke u nisur nga natyra sensitive e çështjes, është shumë e rëndësishme që profesionistët e së drejtës të kenë një tjetër

qasje komunikimi me të miturit, duke përdorur një gjuhë më të thjeshtë dhe më të kuptueshme. Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është në proces bashkëpunimi me disa organizata ndërkombëtare mbështetëse, me qëllim hartimin e protokolleve të komunikimit mbi mënyrën e pritjes dhe ofrimit të shërbimit ligjor falas për të miturit, për të vijuar trajnimet dhe specializimet të dedikuara për këtë kategori. Gjithashtu, nuk mund të mohojmë mbështetjen që na kanë dhënë organizatat jofitimprurëse të autorizuara, të specializuara në fushën e drejtësisë për të mitur, si CRCA apo TLAS.

5. Cili është mesazhi që do të jepni për të gjithë profesionistët që punojnë me të miturit?

Mbrojtja e interesit më të lartë të të miturve, përpos një mision me karakter profesional, mbi të gjitha është një mision moral dhe humanitar. Është detyra jonë, si profesionistë të së drejtës, të ndërmarrim masa dhe të bashkëpunojmë në përmbushjen e këtij misioni.

DREJTËSIA
E BARABARTË
PËR TË GJITHË



INTERVISTË ME PUNONJËSEN E MBROJTJES SË FËMIJËVE PRANË NJËSISË ADMINISTRATIVE NR. 6

1. Prezantimi juaj hyrës...

Unë quhem Blerina Hysi. Kam studiuar Filozofi-Sociologji në Fakultetin e Shkencave Sociale. Prej më shumë se 5 vitesh jam e ngarkuar nga Bashkia Tiranë për të përmbushur detyrën e Punonjësës për Mbrojtjen e Fëmijëve pranë Njesisë Administrative nr. 6. Kjo njësi ka në territorin e saj rreth 75 000 banorë, nga të cilët përafërsisht 15 mijë vlerësohen të jenë nën moshën 18 vjeç, mirëqenia dhe siguria e të drejtave të të cilëve duhet të jetë në vëmendjen e Njesisë për Mbrojtjen e Fëmijëve. Kjo zonë ka një numër të lartë të të miturve në konflikt me ligjin dhe është vërejtur se fëmijët përfshihen në konflikt me ligjin jo rastësisht. Situata e tyre është formuar gradualisht, duke renditur disa faktorë, kryesisht të natyrës sociale.

2. Sa sfiduese është të punoni me të miturit në konflikt me ligjin?

Të punosh me këtë kategori është një sfidë e vërtetë. Rastet shpeshherë janë shumë komplekse, fëmijët janë të përfshirë në shumë situata, ose janë vlerësuar në nevojë për një sërë shërbimesh. Zakonisht nuk gjejmë bashkëpunim nga ana e të miturve. Ata nuk arrijnë ta kuptojnë situatën në të cilën ndodhen, apo pasojat e veprës penale, të cilën kanë kryer. Kanë probleme në sjellje, ose mund të jenë konsumues të lëndëve narkotike.

3. Sa bashkëpunues janë të miturit me PMF në procesin e rehabilitimit?

Të miturit në konflikt me ligjin janë karaktere shumë komplekse, vijnë nga familje

problematike, me histori dhune në familje, familje me një prind ose me prindër disfunksionalë, të cilët nuk kanë aftësitë e duhura për të menaxhuar fëmijët e tyre. Në disa raste, bashkëpunimi me Punonjësin e Mbrojtjes së Fëmijës ka qenë i frytshëm. I mituri ka gjetur ngrohtësi dhe mbështetje, PMF ka qenë kontakti i parë pas një situatë problematike. Gjithashtu ka dhe raste kur i mituri nuk shprehet, nuk bashkëpunon dhe ka probleme në sjellje.

4. Si mendoni, si mund të ishte më i mirë procesi i rehabilitimit? Keni nevojë që aktorët e tjerë të jenë me ju për të bashkëpunuar në këtë proces?

Puna me këtë kategori duhet të fillojë me procesin e parandalimit. Është vërejtur, nga ana ime, që këta fëmijë fillimisht raportohen që në moshën 10 – 11-vjeçare për mosfrekuentim të shkollës, më pas, ndonjëherë, në situatë rruge dhe nëse nuk ndërhyhet në kohë nga të gjithë aktorët, të miturit raportohen në konflikt me ligjin. Raportohet kryesisht për veprën penale të vjedhjes, në më të shumtën e rasteve në bashkëpunim me të mitur të tjerë. Në këtë fazë, menaxhimi i rastit vështirësohet, pasi përfshihen më tepër aktorë dhe shumë elementë të këtij procesi shpeshherë është e vështirë t'i identifikosh. I mituri mund të jetë i detyruar apo i shtrënguar nga persona të tjerë për të kryer veprën penale dhe nuk shprehet për këtë fakt. Është shumë e rëndësishme koordinimi dhe bashkëpunimi e vazhdimësi nga të gjitha strukturat për

menaxhimin në kohë të këtyre rasteve.

5. Cili është roli i familjarëve në këtë proces? A janë bashkëpunues?

Familja është shkaku kryesor prej të cilit një i mitur përfshihet në konflikt me ligjin. Në mënyrë direkte apo indirekte, familja është baza ku formohet karakteri i këtyre të miturve. Nëse ndërhyhet që në fillim prej familjes, situata e të miturve nuk degradon. Shpeshherë familjet nuk janë bashkëpunuese, nuk marrin përgjegjësitë e tyre, nuk i dinë pasojat e veprës penale që janë përfshirë fëmijët e tyre. Madje, ndonjëherë dhe i justifikojnë këto veprime të të miturve, duke u viktimizuar si familje në nevojë, të cilat s'kanë mundësi për t'u përmbushur nevojat fëmijëve të tyre.

6. Nëse do të jepni mesazh për aktorët e tjerë që punojnë me të miturit në konflikt me ligjin, cili do të ishte ai?

Mesazhi im është shumë i thjeshtë, përveç njohjes shumë të mirë të bazës ligjore dhe të të gjitha strukturave që ngarkohen me ligj për të menaxhuar këtë kategori, do të thosha të përpiqen të futen në botën e këtyre të miturve. Aty do të gjenden të gjitha përgjigjet e pyetjeve se janë në atë situatë dhe sesi mund të dalin me sukses prej saj. Të gjithë aktorët duhet të kuptojnë që të miturit, në konflikt me ligjin, kanë karaktere komplekse dhe kanë nevojë për t'u kuptuar drejt prej nesh. Situata e tyre mund të ndryshojë vetëm nëse të gjithë përfshihemi në përmbushjen e nevojave të tyre.



Intervistoi: Esimagra Latifi / Redaktoi dhe korrektori: Luljeta Nelallari



QPKMR
Qendra Publikenetare e Kriminologjise dhe e Mbrojtjes



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E DREJTËSISË



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E KULTURËS



QENDRA KOMBETARE
E LIBRIT DHE LEXIMIT